

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Edukimit. Programi FILLOR |
| Titulli i lëndës: | Mësimdhënia e matematikës II |
| Niveli: | BA |
| Statusi lëndës: | OBLIGATIVE |
| Viti i studimeve: | IV (Sem VII) |
| Numri i orëve në javë: | 3+1 orë |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 ECTS |
| Koha / lokacioni: | |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Dr. Eda Vula dhe asistente Msc. Blerina Tafolli |
| Detajet kontaktuese: | eda.vula@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | |
| | Lënda Mësimdhënia e matematikës II shqyrtohen përgjithësimet, modelet dhe funksionet si bazë për zhvillimin e të menduarit kritik e krijues. Zhvillimi i të menduarit gjeometrik dhe koncepteve themelore gjeometrike duke konsideruar nivelet e Van Heiles, të nxënit për figurat dhe vetitë, konceptet fillestare për matjet dhe të nxënit për transformimet gjeometrike zënë një vend parësor në kurs. Në kurs, do të shqyrtohen edhe konceptet themelore për të dhënat dhe elementet statistikore dhe zhvillimi i koncepteve të probabilitetit. Të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë kursit, mbështeten në mësimdhënien e bazuar në hulumtime, mësimdhënien e bazuar në probleme/projekte, promovimin e edukimit për STEAM dhe zhvillimin e shkathtësive të shekullit të 21-të. me qëllim të përgatitjes së studentëve për mësimdhënës efektiv. |
| Qëllimet e lëndës: | Kursi Mësimdhënia e matematikës II merr parasysh kursin e zhvilluar paraprakisht (MM 1) dhe qëllimi i tij është përgatitja e studentëve për mësimdhënie të matematikës dhe zhvillim të kompetencave të fushës së matematikës. Përgatitja dhe zhvillimi i aftësive të studentëve për një mësimdhënie efektive është qëllim kryesor i kursit. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Studentët: |

| | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • zhvillojnë aktivitete sipas metodave bashkëkohore që kanë për bazë kompetencat themelore të fushës së matematikës; • integrojnë në planet e orëve të matematikës fushat e ndryshme kurrikulare dhe problemet e jetës së përditshme; • harmonizojnë mësimdhënien me nevojat e nxënësve gjatë aktiviteteve me figura gjeometrike, madhësi, matje, punën me të dhënat dhe gjatë zgjidhjes së problemeve nga jeta e përditshme; • planifikojnë aktivitete për figurat gjeometrike sipas niveleve të van Hiele's; • vlerësojnë rëndësinë e shfrytëzimit të manipulativeve dhe teknologjisë gjatë të nxënësve të matematikës; • analizojnë metoda të ndryshme të vlerësimit që kanë për qëllim përparimin e të gjithë nxënësve; • krijojnë plane mësimore dhe aktivitete që nxisin të menduarit kritik, promovojnë edukimin për STEAM dhe vlerat nga të mësuarit e matematikës |
|--|--|

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësve të studentit)

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
|--|------------|------------------|------------------|
| Ligjërata | 3 | 15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 8 | 8 |
| Kollokfiime,seminare | 6 | 1 | 6 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 12 | 24 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 12 | 36 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 3 | 6 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | 2 | 4 |
| Te tjera: Puna ne projekte bashkëpunuese | 3 | 2 | 6 |
| Totali 25x6 = 150 orë | | | 150 orë |

| Metodologjia e mësimdhënies: | <p>Në këtë kurs do të zbatohen metodat ndërvepruese të mësimdhënies, duke i angazhuar studentët në diskutime për çështje të rëndësishme, duke u bërë të mundur që të reflektojnë mbi përvojën e tyre dhe duke i lejuar ata të shprehin idetë e tyre dhe përvojat rreth temave të caktuara.</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|-------------------------------------|---|---------------------|----|---------|-----|-------------------------|-----|----------------------|-----|----------|------|-----------|------|--------|----|-------|---|-------|---|-------|---|-------|---|
| Metodat e vlerësimit: | <p>Nota përfundimtare caktohet sipas vlerësimit të mëposhtëm:</p> <p>Angazhim në diskutime dhe reflektime në ligjërata 5%</p> <table data-bbox="662 667 1182 856"> <tr> <td>Detyrat në ushtrime</td> <td>5%</td> </tr> <tr> <td>Testi 1</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Projektet bashkëpunuese</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>100%</td> </tr> </table> <p>Nota përfundimtare :</p> <table data-bbox="662 940 922 1171"> <thead> <tr> <th>Pikët (%)</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>92-100</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>80-91</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>70-79</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>60-69</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>50-59</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> | Detyrat në ushtrime | 5% | Testi 1 | 20% | Projektet bashkëpunuese | 20% | Provimi përfundimtar | 50% | Gjithsej | 100% | Pikët (%) | Nota | 92-100 | 10 | 80-91 | 9 | 70-79 | 8 | 60-69 | 7 | 50-59 | 6 |
| Detyrat në ushtrime | 5% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Testi 1 | 20% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Projektet bashkëpunuese | 20% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Provimi përfundimtar | 50% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Gjithsej | 100% | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Pikët (%) | Nota | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 92-100 | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 80-91 | 9 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 70-79 | 8 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 60-69 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 50-59 | 6 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Literatura | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Literatura bazë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Reys, Robert E; Linquist , Mary M; Lambdin, Diana V; Smith, Nancy L;. (2007). Helping Children Learn Mathematics. Hoboken, NJ: John Wiley & Sons, Inc 2. Van de Walle, J. Karp, K., Bay-Williams, J., & Wray, J. (2013). Elementary and middle school mathematics: Teaching developmentally (8th ed.). Pearson Education. Inc. 3. Aichele, B., D., & Walfe, J. (2008). Geometric Structures. An Inquiry-Based Approach for Prospective Elementary and Middle School Teachers. Pearson Education. Inc. | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Literatura shtesë: | <p><i>Tekstet mësimore (kl I-V)</i> <i>Kurrikula e Kosovës. Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (klasat, 0,I,II,III.IV dhe V). Planet dhe Programet më Mësimore,</i> http://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Shënim: Gjatë kursit studentët do të lexojnë edhe artikuj të sygjeruar shkencor dhe profesional nga fusha e edukimit matematikor.

Plani i dizajnuar i mësimi:

| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
|------------------------------|--|
| <i>Java e parë:</i> | Paraqitja e kursit – detyrat |
| <i>Java e dytë:</i> | Elementet e planifikimit dhe strategjitë e mësimdhënies (Rishikim i MM1) |
| <i>Java e tretë:</i> | Zhvillimi i të menduarit gjeometrik dhe konceptet themelore gjeometrike . Nivelet e Van Heiles |
| <i>Java e katërt:</i> | Nivelet e Van Heiles (vazhdim - planifikim) |
| <i>Java e pestë:</i> | Të nxënit për figurat dy dhe tri dimensionale |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Konceptet fillestare për matjet dhe ZP. Planifikimi i aktiviteteve |
| <i>Java e shtatë:</i> | Zbatimi i matjeve të madhësive (perimetër, syprinë, vëllim) në zgjidhjen e problemeve. Shfrytëzimi i teknologjisë. |
| <i>Java e tetë:</i> | Testi 1 |
| <i>Java e nëntë:</i> | Të nxënit për transformimet gjeometrike |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Mësimdhënia e matematikës përmes integritit STEAM. Përgatitjet për projektet bashkëpunuese. |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Problemet matematikore dhe promovimi i vlerave përmes të mësuarit të matematikës. |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Zhvillimi i koncepteve themelore për të dhënat dhe elementet statistikore. Analiza e të dhënave dhe paraqitjet grafike |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Zhvillimi i koncepteve të probabilitetit. Shembuj të planifikimeve |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Prezantimi i projekteve |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Provimi përfundimtar |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Studentët janë të obliguar të vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet; ata janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.
- Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohen telefonat celularë.
- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye
- Kopjimet gjatë provimeve dhe kryerjes së detyrave ndëshkohen sipas procedurave të miratuara në fakultet.
- Në provimin përfundimtar kanë të drejt të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në detyrat gjatë vijimit të kursit në ushtrime dhe ligjëratat.
- Studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar deri në tri herë (Neni 118 (1) i Statutit të UP-së)